



UNIVERSITETI I TETOVËS

UNIVERSITY OF TETOVA - ШИБЕПАРТЕ I БО ТЕ ТОВО
U.T. Rectorate - Himen n. 1200 Tetovo, Macedonia
Tel: +389 44 556 500, Fax: +389 44 334 222, email: international@unite.edu.mk

DREJTUAR: KËSHILLIT MËSIMOR – SHKENCOR TË FAKULTETIT EKONOMIK

CIKLI I TRETË I STUDIMEVE

RAPORT PËR VLERËSIMIN E PUNIMIT TË DOKTORATURËS TË KANDIDATËS - Mr.sc. DONJETA MORINA

Në bazë të vendimit nr. 14 – 756/3 të datës 10. 09. 2021 të Këshillit mësimor - shkencor të Fakultetit Ekonomik, për formimin e komisionit për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoratës, si dhe në bazë të nenit 51 të Rregullorës për kushtet, kriteret dhe rregullat e regjistrimit dhe studimit në ciklin e tretë të studimeve – studimet e doktoratës në Universitetin e Tetovës, komisioni në përbërje:

1. Prof. dr. Ibish Mazreku, kryetar
2. Prof. dr. Shirete Elezi, anëtar
3. Prof. dr. Etem Iseni, anëtar
4. Prof. dr. Arun Tairi, anëtar
5. Prof. dr. Bardhyl Dauti, anëtar

Komisioni pas vlerësimit të punimit të doktoratës me titull: “**Ndikimi i menaxhimit efektiv të kredisë në përfitueshmërinë e bankave komerciale në Kosovë**”, të kandidatës **Mr. sc. Donjeta Morina**, paraqet këtë:

RAPORT PËR VLERËSIMIN E PUNIMIT TË DOKTORATURËS

Informacion lidhur me temën e hulumtimit

Në mesin e ndërmjetësve financiar, bankat komerciale konsiderohet të kenë rolin më të rëndësishëm në funksionimin e çdo ekonomie. Funkzioni i tyre është kalimi i mjeteve financiare nga ata që kanë teprica tek ata që kanë nevojë për fonde shtesë duke mundësuar në këtë mënyrë realizimin e investimeve në ekonomi. Një funksion i tillë i bankave komerciale bëhet i mundur vetëm nëse bankat gjenerojnë të ardhura të mjaftueshme nga aktivitetet e tyre, prandaj është shumë e rëndësishme të analizohet profiti i këtyre bankave. Fitimi i bankës është një tregues i kapacitetit të bankave për të përballuar rrezikun ose për të rritur kapitalin e tyre. Tregon aftësinë e bankës dhe matë cilësinë e menaxhimit. Rreziqet me të cilat përballen bankat janë të pashmangshme dhe duhet të vlerësohen, kontrollohen dhe neutralizohen financiarisht në mënyrë që të mos rrezikojnë biznesin e bankës. Menaxhimi i rrezikut do të thotë, rritje e mundësisë për sukses, zvogëlim i mundësisë së dështimit dhe kufizim i pasigurisë lidhur me performancën e bankave.

Bankat, sot ofrojnë produkte dhe shërbime të ndryshme për publikun dhe në mesin e këtyre produkteve dhe shërbimeve, dhënia e kredive konsiderohet si aktiviteti kryesor nga i cili ato gjenerojnë të ardhura. Gjatë kryerjes së aktiviteteve të tyre, bankat komerciale përballen më shumë rreziqe të cilat pengojnë funksionimin e duhur të tyre dhe afektojnë negativisht në performancën e tyre financiare. Duke marrë parasysh faktin se këto banka aktivitet kryesor e kanë dhëniën e kredive, rreziku i kredisë është dukshëm rreziku më i madh dhe me i rëndësishëm me të cilin ato përballen, prandaj sukcesi i tyre varet nga matja dhe menaxhimi i saktë i këtij rreziku.

Ky rrezik i njohur si rreziku i performancës ose rreziku i kundërpalës përkufizohet si mundësi që një palë kontraktuese të mos përmbushë detyrimet e saj në përputhje me kushtet e parapara më kontratë (Brown & Moles, 2012), dhe kjo mund ta vendosë bankën në vështirësi në qoftë se nuk arrihet të menaxhohet si duhet. Meqë kredia është në qendër të vëmendjes së çdo banke, atëherë edhe fokusi kryesor i bankave është drejtimi i riskut të kredisë. Menaxhimi i këtij risku përfshinë procesin e vendimmarrjes, para se vendimi për kredinë të merret, përcjelljen e zotimeve të kreditit duke përfshirë gjithë procesin e

monitorimit dhe raportimit të kredisë. Kreditimi kërkon që bankat të vlerësojnë aftësinë kreditore të huamarrësve për të përmbushur detyrimet e parapara, përndryshe kjo mund të shkaktoj probleme të mëdha për bankat, duke rritur nivelin e kredive joperformuese dhe duke ndikuar kështu në rritjen e mundësive për dështim. Për atë, është e nevojshme të bëhet menaxhimi i kredive si masë vendimtare për mbijetesën dhe rritjen e këtyre institucioneve (Affriyie & Akotey, 2012). Menaxhimi i rrezikut të kredisë është i përqëndruar në uljen e luhatshmërisë së fitimit dhe shmangien e humbjeve të mëdha. Vlerësimi i cilësisë, menaxhimi i rrezikut dhe krijimi i rezervave adekuate për borxhet e këqija dhe të dyshimta zvogëlojnë rrezikun e kredisë (Wandera, 2013). Vlerësimi i kujdesshëm i rrezikut të kredisë dhe krijimi i rezervave për borxhet e këqija mund të ndikoj dukshëm në uljen e rrezikut kreditor për bankat dhe rritjen e profitit të tyre. Menaxhimi efektiv i rrezikut të kredisë përfshinë krijimin e një mjedisi të përshtatshëm, që vepron në një mjedis të shëndoshë të dhëniës së kredisë dhe administrimin e duhur të kredisë, që përfshinë procesin e monitorimit si dhe kontrollin e kënaqshëm mbi këtë lloj rreziku (Gaitho, 2013).

Në mjediset e sotme me presione konkurruese dhe kushte të paqëndrueshme ekonomike, aftësia e bankave për të menaxhuar rrezikun kreditor mund të nënkuptoj dallimin midis suksesit dhe mbijetesës (Altman, 2002). Dekada e kaluar ka parë humbje dramatike në industrinë bankare. Në përgjigje të kësaj, bankat kanë filluar universalisht përmirësimin e sistemit të menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit të kredive. Vlerësimi i kujdesshëm i rrezikut të kredisë dhe krijimi i rezervave për borxhet e këqija mund të ndikoj në uljen e rrezikut kreditor për bankat dhe rritjen e profitit të tyre.

Bankat komerciale në Kosovë kanë evoluar sa i përket ofrimit të produkteve dhe shërbimeve bankare në treg. Sektori bankar vazhdimisht punon në përmirësimin e performancës, zhvillimin e operacioneve bankare, inovacioneve dhe risive dinamike që kërkon tregu. Industria bankare në Kosovë ka arritur të implementoj korniza ndërkombëtare të standardizimit, të modernizoj shërbimet bankare dhe të ofroj produkte inovative, duke krijuar mundësi të reja të përmirësimit të ambientit të përgjithshëm afarist dhe rritjes së konkurrencës. Rritja e produkteve dhe shërbimeve të ofruara nga bankat komerciale në Kosovë, ka ndikuar në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Ky sektor është karakterizuar vazhdimisht me nivel të lartë të qëndrueshmërisë që ka buruar nga

aplikimi i politikave konservative të kreditimit nga ana e bankave komerciale dhe mbikëqyrja konservative nga rregullatori. Mbikëqyrja bankare në Kosovë përfshinë procesin e monitorimit të bankave për t'u siguruar që ato janë duke i kryer aktivitetet e tyre në përputhje me rregullat dhe ligjet në fuqi. Kjo mbikëqyrje ka zgjedhur qasje graduale të përafrimit me standardet ndërkombëtare me fokus të veçantë me direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian për mbikëqyrjen e bankave. Nevoja për rregullim dhe mbikëqyrje të sektorit bankar qëndron në rëndësinë e këtij sektori në ekonominë e tregut sepse bankat në fakt janë shpërndarësit kryesor të fondeve në ekonomi.

Dhënia e kredive nga ana e bankave komerciale kërkon angazhim të madh të fondeve. Arsyeshmëria e menaxhimit të kredive është të minimizoj humbjet e mundëshme nga veprimtaria kreditore, si rezultat i moskthimit të huave të marra nga ana e klientëve ose si rezultat i ekzistencës së rrezikut kreditor. Përderisa ky rrezik buron nga përbërja e klientëve, kompleksiteti i këtij rreziku dhe aftësia e bankës për ta menaxhuar atë varet nga qasja e ndërmarrë për të siguruar menaxhim të shëndetshëm. Menaxhimi i shëndoshë i kredive është parakusht për stabilitetin dhe performancën e këtyre bankave, ndërkohë që përkeqësimi i cilësisë së kredive është shkaku kryesor për performancë të dobët. Për këtë arsye menaxhimi i kredive ka tërheqë çdoherë vëmendjen e studiuesve për hulumtime dhe ka zgjuar dëshirën e kandidatës **Donjeta Morina** për të parë se *'Cili është ndikimi i menaxhimit efektiv të kredive në përfitueshmërinë e bankave komerciale në Kosovë (të matur më treguesit e përfitueshmërisë, ROA dhe ROE).*

Informacione lidhur me gjendjen në fushën shkencore në të cilën është punuar disertacioni

Aftësia e një banke për të realizuar fitime dhe për të qëndruar në veprim varet nga mënyra se si mund të krijoj hapësirë të mjaftueshme për të shmangur rreziqet, por më e rëndësishmja të jetë në gjendje të reagoj pozitivisht ndaj humbjeve nga kreditë me probleme (Bobakovia, 2003). Menaxhimi i rrezikut të kredisë përshkruhet si armë e fortë e përdorur nga menaxhmenti për të rritur kthimet e bankës duke sjellur rrezikun e kredisë në minimumin e tij më të ulët. Rreziku i kredisë, i cili është rezultat i menaxhimit joefektiv, është një nga katalizatorët kryesorë të bankave. Për më tepër, shkalla në të cilën kontrollohet rreziku i kredisë ka ndikim në progresin dhe qëndrueshmërinë e atij

institucioni financiar dhe të ekonomisë në terësi. Një kornizë e shëndoshë e menaxhimit të kredisë konsiderohet vendimtare për rritjen e përfitueshmërisë dhe mbijetesën e bankave komerciale.

Ka patur vazhdimisht debate dhe kundërthënie mbi ndikimin e menaxhimit të rrezikut të kredisë në performancën financiare të bankave. Gjatë disa dekadave, shumë studiues kryen shumë studime të gjera mbi këtë temë dhe prodhuan rezultate të perziera. Për rolin e menaxhimit të kredisë në profitin e sektorit bankar është folur shumë nga autorë të huaj në studimet e tyre të zhvilluara në vende të ndryshme, ndërsa tek ne nuk konsiderohet se ka studime që japin rezultate fiktive lidhur me këtë temë. Shumica e studiuesve janë fokusuar në një ose disa vende dhe kanë treguar rezultate të ndryshme mbi marrëdhënien në mes të menaxhimit të kredisë dhe profitabilitetit të bankave.

Lalon (2015), në studimin e tij për bankat komerciale në Bangladesh për periudhën 2008 – 2012, është munduar të identifikoj lidhjen që ekziston në mes të menaxhimit të kredisë dhe përfitueshmërisë bankare. Rezultatet e studimit të tij kanë dhënë marrëdhënie pozitive në mes të menaxhimit të rrezikut dhe treguesve të përfitueshmërisë (ROA dhe ROE). Si tregues të rrezikut të kredisë ai ka marrur raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit, raportin e kredive joperformuese dhe raportin e provizionit për humbjet nga kreditë. Në studim është gjetur marrëdhënie e rëndësishme në mes të këtyre faktorëve dhe profitabilitetit të bankave, ku raporti i kredive joperformuese ndikonte negativisht në profitabilitet ndërsa dy raportet e tjera me një ndikim pozitiv jo shumë të rëndësishëm. Një tjetër studim i kryer në Bangladesh që tregon lidhjen e rëndësishme në mes të menaxhimit të rrezikut të kredisë dhe profitit të bankave është edhe studimi i kryer nga Sufian & Kamarudin (2012). Ky studim ishte kryer në 31 banka për periudhën 2000 – 2010 dhe kishte dhënë rezultate të përafërta me studimin e Lalon.

Në studimin e kryer nga Capraru & Ilnatov (2014), u analizua përfitueshmëria e bankave komerciale në vendet e Evropës Qendrore duke përfshirë këtu, Rumaninë, Çekinë, Poloninë, Hungarinë dhe Bullgarinë për periudhën 2004 – 2011. Objekt i studimit kanë qenë 143 banka komerciale të këtyre vendeve. Ky studim konkludon se efikasiteti i menaxhimit të kredisë në rast konkret mjaftueshmëria e kapitalit si matës i administrimit të kredisë ka ndikuar në masë të madhe në treguesit e përfitueshmërisë, të marrë këtu

përveç ROA dhe ROE edhe marzhin neto të interesave (NIM). Ndikimin me të madh mjaftueshmëria e kapitalit shihet të ketë në ROE. Sipas këtyre autorëve bankat të cilat kanë raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit më të lartë janë më fitimprurëse dhe kanë tregues me të lartë të përfitueshmërisë. Kaaya dhe Pastory (2013), rekomandojnë që bankat duhet të mbajnë një sasi të konsiderueshme të rezervës kapitale për të absorbuar rrezikun e kredisë në rast të dështimit.

Një tjetër studim është kryer në Evropë nga Li dhe Zou (2014), ku janë marrë për studim 47 bankat komerciale më të mëdha në Evropë (të zgjidhura sipas madhësisë së totalit të aktiveve) dhe janë studiuar për periudhën 2007 – 2012. Autorët kanë përdorur ROA dhe ROE si tregues të përfitueshmërisë ndërsa kreditë jopërfomuese dhe raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit si tregues të rrezikut të kredisë. Studimi ka treguar se mjaftueshmëria e kapitalit nuk kishte ndikim të rëndësishëm në këta treguesit ndërsa kreditë jopërfomuese kishin ndikim negativ në të dy këta tregues (ROA dhe ROE).

Poudel (2012), gjatë një studimi që bëri mbi faktorët që ndikojnë në profitin e 31 bankave tregtare në Nepal për periudhën 2001 – 2011, zbuloi një marrëdhënie të rëndësishme pozitive në mes të menaxhimit të kredisë dhe përfitueshmërisë së këtyre bankave. Sipas tij, rreziku i kredisë i matur nga kreditë më probleme dhe nga humbjet nga kreditë ka ndikim negativ në fitimin e këtyre bankave dhe se menaxhimi i mirë i rrezikut të kredisë është një parashikues i rëndësishëm i performancës financiare.

Më gjithëpërfshirës në studimin e tyre ishin Kolapo et al. (2012), të cilët përdorën analizën e të dhënave të panelit për bankat komerciale në Nigeri. Përmes këtij studimi i cili u shtri për një periudhë 11 vjeçare (2000 – 2010), në 5 banka në Nigeri u pa ndikimi i rrezikut të kredisë në përfitueshmërinë e këtyre bankave duke përdorur ROA si matës të performancës. Sipas këtyre autorëve, një rritje 100% në kreditë jopërfomuese e zvogëlon profitin për 6.2%, ndërkohë që një rritje në totalin e kredive rritë profitin e këtyre bankave.

Një studim tjetër i kryer nga Hosna et. al. (2009), gjithashtu ka gjetur marrëdhënie pozitive midis menaxhimit të rrezikut të kredisë dhe përfitimit të bankave për vitet 2000 – 2008 në Suedi. Këta autorë kanë studiuar katër banka komerciale dhe kanë ardhur në përfundim së kredia jopërfomuese dhe raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit si tregues të

rrezikut të kredisë kishin ndikim të rëndësishëm në ROE të këtyre bankave. Ky studim konsiderohet i kufizuar për shkak të mostrës jo gjithpërfshirëse për bankat komerciale të Suedisë. Rezultatet e tyre të nxjerrura me modelin e regresionit kanë dhënë një ndikim më të fuqishëm të kredive joperformuese në profitin e bankave në Suedi, krahas mjaftueshmërisë së kapitalit. Një rritje në numrin e kredive joperformuese ndikon negativisht në profitin e bankave dhe se një rritje në sasinë e kredive joperformuese është rezultat i mungesës së menaxhimit të kredive që kërcnon performancën financiare të bankave. Baza e menaxhimit të kredisë mund të përshkruhet si një funksion që duhet të kryhet nga bankat komerciale në mënyrë që të sigurohet që huatë që ato i kalojnë tek klientët të kthehen më rregull. Përdorimi i kontroleve të kredisë në baza të rregullta rritë menaxhimin e kredisë. Ndëshkimet për pagesa me vonesë rrisin angazhimin e klientëve për shlyerjen e kredive. Menaxhimi efektiv i rrezikut të kredisë është komponent kyç i një qasje gjithpërfshirëse në procesin e menaxhimit të rrezikut kreditor dhe është thelbësor për suksesin afatgjatë të çdo banke komerciale, Hull (2015).

Qëllimi i punimit

Bankat duke qenë institucionet me të rëndësishme brenda sistemit financiar, ofrojnë produkte dhe shërbime të ndryshme për publikun. Në mesin e këtyre produkteve dhe shërbimeve që ato ofrojnë, dhënia e kredive paraqet aktivitetin kryesorë dhe me të rëndësishëm nga i cili ato gjenerojnë fitime. Gjatë kryerjes së këtij aktiviteti ato përballën me rreziqe të shumta dhe në mesin e rreziqeve me të cilin ato përballën rreziku kreditor është dukshëm rreziku më i rëndësishëm i cili pengon funksionimin normal të këtyre bankave dhe afekton negativisht në performancën e tyre financiare. Duke u bazuar në këtë, faktori kyç që përcakton suksesin dhe mbijetesën e çdo banke komerciale është menaxhimi efektiv i kredive, i cili arrihet përmes kontrollimit të vazhdueshëm të aktivitetit kredidhënës.

Qëllimi themelor i këtij punimi në terësi është të analizoj ndikimin e menaxhimit të kredive në përfitueshmërinë e bankave komerciale në Kosovë për periudhën 2012 – 2018. Për arritjen e këtij qëllimi, punimi synon të arrijë objektivat si më poshtë:

1. Të përcaktoj ndikimin e kredive joperformuese në përfitueshmërinë e bankave komerciale në Kosovë për periudhën 2012 – 2018;

2. Të vlerësoj nëse ka një marrëdhënie midis mjaftueshmërisë së kapitalit dhe përfitueshmërisë së bankave komerciale në Kosovë;
3. Të përcaktoj ndikimin e provizioneve për humbjet nga kreditë në nivelin e përfitueshmërisë e bankave komerciale në Kosovë;
4. Të përcaktoj se sa ndikon madhësia e asteve të bankës në përfitueshmërinë e saj; dhe
5. Të sugjerohet zgjidhje e mundshme për përmirësimin e menaxhimit të rrezikut të kredisë, duke u bazuar në gjetjet ekzistuese.

Është më rëndësi që përmes arritjes së këtyre objektivave të konstatohet ndikimi i menaxhimit të kredive në përfitueshmërinë e bankave komerciale në Kosovë.

Duke u bazuar në qëllimet e punimit kandidatja ka parashtruar disa pyetje kërkimore, të cilat kanë ndihmuar në realizimin dhe kuptimin më të mirë të temës së studiuar:

1. Cili është ndikimi i kredive joperformuese në përfitueshmërinë e bankave komerciale në Kosovë për periudhën 2012 – 2018?
2. Çfarë ndikimi ka përcaktimi i mjaftueshmërisë së kapitalit në nivelin e përfitueshmërisë së bankave komerciale në Kosovë?
3. Sa ndikon provizionimi i humbjeve nga kreditë në nivelin e përfitimeve të siguruara nga bankat komerciale në Kosovë?
4. Sa ka ndikim rritja e aseteve në rritjen e përfitimeve për bankat komerciale në Kosovë?

Pyetjet kërkimore të parashtruara kanë ndihmuar kandidaten në ndërtimin e modeleve përkatëse për të nxjerrë rezultate empirike në funksion të realizimit të qëllimeve të disertacionit. Është më rëndësi që përmes dhënies së përgjigjeve të këtyre pyetjeve të konstatohet ndikimi i menaxhimit të kredive në përfitueshmërinë e bankave komerciale në Kosovë.

Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura

Metodologjia e punimit përcaktohet gjithmonë duke u bazuar në temën e zgjedhur dhe objektivat e studimit. Duke marrë parasysh këtë fakt, punimi është i bazuar tërësisht në të dhëna sekondare. Në rastin konkret, përdorimi i të dhënave sekondare shihet si më përparësi krahas të dhënave primare, për faktin se të dhënat e përdorura në studim janë të

publikuara nga institucionet relevante siç janë bankat komerciale dhe besueshmëria e tyre është shumë e lartë. Të dhënat e përdorura janë të besueshme për faktin se janë të publikuara nga institucionet relevante dhe janë në dispozicion në një format publik, janë të përshtatshme sepse i përgjigjën plotësisht temës dhe qëllimit të studimit dhe gjithashtu ka në dispozicion të dhëna të mjaftueshme për të realizuar me sukses studimin.

Mostra e studimit përfshinë tetë banka komerciale. Për të parë ndikimin e menaxhimit të kredisë në përfitueshmërinë e bankave komerciale në Kosovë, kandidatja ka mbledhur të dhënat e nevojshme nga këto tetë banka për një periudhë prej shtatë viteve, përkatësisht vitet 2012 – 2018. Të dhënat e nevojshme janë grumbulluar nga raportet financiare të publikuara nga bankat e marra në studim, si raportet e indikatorëve kryesor financiar dhe pasqyrat financiare (bilanci i gjendjes dhe pasqyra e të ardhurave) në baza tremujore. Sa i përket sigurimit të të dhënave të nevojshme për studim, qasja në të dhënat e bankave ka qenë e lehtë për faktin se bankat komerciale në vend ofrojnë një bazë të dhënash e cila bazë ka qasje publike për përdoruesit dhe të interesuarit.

Për të realizuar me më sukses pjesën e hulumtimit, studimi u bazua në të dhënat e panelit si kombinim i serive kohore dhe të dhënave ndërseksionale. Të dhënat e mbledhura nga bankat janë analizuar për çdo tremujor në mostrën prej tetë bankave. Seritë kohore tremujore në këtë rast kanë paraqitur një formë shumë të përshtatshme për studimin tonë për shkak se periudha e studimit është e shkurtër, dhe të dhënat tremujore në këtë rast kanë rritur numrin e vëzhgimeve dhe kanë bërë të mundur testimin me të mirë të lidhjes që ekziston në mes të variablave të studimit. Përdorimi i të dhënave të panelit në përgjithësi, si kombinim i serive kohore dhe të dhënave ndërseksionale ka dhënë më shumë vëzhgime për shkak se këto të dhëna përbëhen nga një informacion i kryqëzuar sipas bankave dhe atë ndër vite.

Një rol të rëndësishëm në realizimin e hulumtimit ka luajtur përcaktimi i variablave të duhura për studim. Përcaktimi i variablave është bërë duke u bazuar fillimisht në të dhënat në dispozicion dhe duke u bazuar në nivelin e rëndësisë së tyre. Për matjen e përfitueshmërisë studimi përdorë dy treguesit kryesorë të përfitueshmërisë, kthimin nga aktivet (ROA) dhe kthimin nga kapitali (ROE) si variabla të varura të studimit, ndërsa si variabla të pavarura janë përdorur indikatorët e rrezikut kreditor, raporti i likuiditetit dhe përcaktues të tjerë të rëndësishëm në përcaktimin e përfitueshmërisë së bankave

komerciale. Të dhënat e mbledhura përpunohen më anë të metodës sasiore, duke përdorur programin statistikor STATA. Duke përdorur variablat e përcaktuara dhe për t'i dhënë përgjigje qëllimit kryesor të disertacionit, janë ndërtuar dy modele ekonometrike, me variablat e varura ROA dhe ROE. Modelet ekonometrike janë ndërtuar duke u bazuar në të dhënat e panelit, si një nga metodat më të përshtatshme dhe më të rëndësishme të modelimit ekonometrik që i është përshtatur këtij studimi. Studimi ka analizuar të dhënat e panelit përmes metodave si në vijim:

- Metoda e zakonshme e katrorëve të vegjël (Ordinary Least Squares - OLS);
- Metoda me efekte fikse (Fixed Effect Method - FEM);
- Metoda me efekte të rastit (Random Effect Method - REM); dhe
- Metoda e katrorëve të vegjël me variabla fiktive – dummy (Least Squares Dummy Variable – LSDV).

Në mënyrë që të dhënat të analizohen nga pikëpamja sasiore, analizimi dhe përpunimi i tyre është realizuar më softuerin statistikor STATA. Përmes këtij softueri janë llogaritur statistikatat përshkruese (mesatarja, vlera minimale, vlera maksimale dhe devijimi standard) të variablave të studimit, matrica e korrelacionit për zbulimin e prezencës së multikolinearitetit dhe regresioni i të dhënave të panelit, për të përcaktuar ndikimin e menaxhimit të kredisë në përfitueshmërinë e bankave komerciale në Kosovë. Gjithashtu përmes këtij programi janë kryer edhe testet diagnostikuese për të parë rëndësinë dhe përshtatshmërinë e modeleve të zgjedhura.

Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit

Gjetjet empirike mbi ndikimin e menaxhimit të kredisë në përfitueshmërinë e bankave komerciale në Kosovë, kanë dhënë rezultatet e mëposhtme:

- *Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit* ka rezultuar të ketë ndikim pozitiv në përfitueshmërinë e bankave komerciale, përkatësisht ndikim pozitiv në dy treguesit e përfitueshmërisë, në ROA (kthimi nga aktivet) dhe ROE (kthimin nga kapitali). Në të dy modelet ekonometrike të ndërtuara në punim, lidhja e mjaftueshmërisë së kapitalit me treguesit e përfitueshmërisë ka qenë lidhje pozitive dhe e rëndësishme, çka ka dëshmuar edhe pranimin e hipotezës mbi ekzistimin e një lidhje të rëndësishme

pozitive në mes të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe përfitueshmërisë së bankave komerciale në Kosovë. Pranimi i kësaj hipoteze ka rikonfirmuar edhe supozimet teorike se me një nivel të lartë të mjaftueshmërisë së kapitalit, bankat janë në gjendje të thithin çdo humbje eventuale dhe të financojnë operacionet e tyre biznesore, gjë që ndikon pastaj në rritjen e përfitueshmërisë. Ky raport ndër vitë ka qenë në nivelin e përcaktuar nga Banka Qendrore e Kosovës, gjë që nënkupton një element pozitiv për sektorin bankar në Kosovë për faktin se kapitali konsiderohet shtylla kryesore për mbulimin e humbjeve në rast të ndodhjeve të papritura në sektorin bankar.

- *Raporti i kredive joperformuese* si indikator kryesor i menaxhimit të rrezikut kreditor është i lidhur negativisht me përfitueshmërinë e Bankave komerciale në Kosovë. Bankat me norma të larta të kredive joperformuese tentojnë të kenë përfitime me të ulëta krahas atyre me nivel të ulët të këtij indikator. Kjo vërteton edhe faktin se me kalimin e viteve, sistemi bankar në Kosovë është karakterizuar me normë të ulët të kredive joperformuese dhe përfitueshmëri të lartë. Sipas rezultateve të analizës, ndikimi i kredive joperformuese në përfitueshmërinë bankare është i rëndësishëm, çka ka vërtetuar edhe hipotezën mbi ekzistimin e një marrëdhënie negative në mes të kredive joperformuese dhe përfitueshmërisë së bankave komerciale. Për faktin se ky raport konsiderohet indikator kryesor i menaxhimit të rrezikut kreditor, bankat komerciale kanë aplikuar dhe duhet të aplikojnë vazhdimisht politika të kujdesshme të menaxhimit të rrezikut të kredisë, politika këto që ulin raportin e këtyre kredive dhe rrisin aftësinë paguese të klientëve.
- *Madhësia e bankave* e matur si logaritmi total i aseteve të bankës është një indikator i rëndësishëm i përfitueshmërisë së bankave komerciale. Duke marrë parasysh këtë dhe rezultatet e studimit, madhësia e bankave ka ndikim pozitiv në përfitueshmërinë e bankave komerciale. Lidhja pozitive ka rezultuar të jetë e rëndësishme në të dy modelet ekonometrike, çka ka nënkuptuar edhe pranimin e hipotezës mbi supozimin e ekzistimit të një marrëdhënie të rëndësishme pozitive midis madhësisë së bankës dhe nivelit të përfitueshmërisë. Një faktor i rëndësishëm i rritjes së aseteve të bankës është edhe rritja e nivelit të kredive të dhëna. Për faktin se ato përbëjnë burimin kryesor të hyrave të bankave, duke ndikuar kështu në rritjen e përfitimeve të bankave.

- *Raporti i provizioneve për humbjet nga kreditë* ka rezultuar të jetë i lidhur negativisht me përfitueshmërinë e bankave komerciale, rezultat ky që ka mbështetje të gjerë në literaturë. Kjo lidhje ka rezultuar të jetë statistikisht e rëndësishme në të dy modelet ekonometrike. Lidhja statistikore e rëndësishme ka argumentuar edhe pranimin e hipotezës mbi ekzistimin e një marrëdhënie negative në mes të provizioneve për humbjet nga kreditë dhe përfitueshmërisë së bankave komerciale në Kosovë. Kjo na jep të kuptojmë se ndarja e fondeve për të thithur interes nga investimet që mund të kryhen me to, pra sa më shumë që rriten rezervat për humbjet nga kreditë aq më pak banka ka para në dispozicion për t'i investuar dhe për të fituar interes.
- *Norma e interesit në kredi* është e lidhur negativisht me përfitueshmërinë e bankave komerciale në Kosovë. Kjo lidhje negative ka rezultuar e rëndësishme tek të dy modelet ekonometrike. Me kalimin e viteve, norma e interesit në kredi është zvogëluar dhe si rezultat i kësaj është rritur kredidhënia bankare, e cila ka rezultuar me rritjen e fitimeve nga interesat dhe rritjen e përfitueshmërisë në përgjithësi.
- *Likuiditeti i bankave* i matur me raportin kredi/ depozita sipas analizës ka rezultuar të jetë i pa rëndësishëm në përcaktimin e përfitueshmërisë së bankave komerciale në Kosovë.

Punimi ka arritur të identifikoj rëndësinë e menaxhimit të kredisë si një parashikues i rëndësishëm i performancës financiare të bankave komerciale, duke treguar kështu se sukcesi i bankës në aspektin e realizimit të fitimeve varet nga menaxhimi efikas i kredive. Mund të konstatojmë gjithashtu se një rol të rëndësishëm në menaxhimin e kredive ka edhe fuqia mbikëqyrëse e Bankës qendrore, e cila përmes rregulloreve të ndryshme ka arritur të disiplinojë tregun bankar në Kosovë dhe gjithashtu ka arritur implementimin e rregulloreve ndërkombëtare për menaxhimin e rreziqeve.

PËRFUNDIM

Kontributet kryesore shkencore të kandidatit

Kandidatja Mr.Sc. Donjeta Morina, në mënyrë aktive është përfshirë në hulumtimin dhe analizën e problemeve që janë të lidhura në mënyrë direkte ose indirekte me punimin e disertacionit në fjalë. Gjatë periudhës së realizimit të disertacionit, kandidatja ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore tematike për problematikën në fjalë. Anagazhimi i kandidatës përfshinë prezantime të punimeve shkencore në konferenca vendore dhe

ndërkombëtare dhe gjithashtu publikim të punimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare, me indeksim në Scopus dhe Web of Science. Punimet e publikuara në këto revista kanë qenë pjesë e hulumtimeve të bëra për disertacionin e doktoraturës së kandidatës dhe lidhën direkt me hulumtimin e realizuar në disertacion.

Që nga viti 2016, kandidatja është asistente e rregullt në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, dhe nga atëherë mban ushtrimet e lëndëve Bazat e financave, Tregjet dhe institucionet financiare, Financat ndërkombëtare, Menaxhmenti bankar, Metodatat kualitative të kërkimit dhe Metodatat kuantitative të kërkimit.

Në periudhën e fundit, kandidatja ka marrë pjesë edhe në disa workshope dhe trajnime me karakter ndërkombëtar. Vlenë të përmendet përvoja e fituar mbi hulumtimet shkencore në Universitetin e Zagrebit dhe pjesëmarrja në trajnimin e realizuar për stafin akademik në Universitetin e shkencave të aplikuara në Salzburg.

Fusha shkencore në të cilën do të aplikohën

Sipas shtjellimit të tematikës që ka arritur kjo temë disertacioni, konsiderojmë se kandidatja ka dhënë kontribut të rëndësishëm në trajtimin e problematikave kyçe në sektorin bankar. Në pjesën e fundit të disertacionit, kandidatja ka dhënë përfundimet e punimit dhe rekomandimet, ku përmenden sferat në të cilat këto rekomandime mund të gjejnë zbatim.

Rezultatet e arritura nga realizimi i këtij hulumtimi do të gjejnë zbatim të konsiderueshëm në hulumtimet e ardhshme shkencore, të cilat hulumtime mund të bazohen në këto rezultate si pikënisje e mirëfilltë për hulumtimet që do të realizohen mbi sektorin bankar.

Ky punim rekomandon që rezultatet e ofruara të përdoren si bazë për përmirësime të nevojshme në sferën e sektorit bankar, të cilat do të ndikojnë në fuqizimin tutje të këtij sektori duke i lehtësuar atij aktivitetet të cilat i gjenerojnë fitim. Përveçse për studime shkencore në të ardhmen, rezultatet e punimit të kandidatës shumë lehtë mund të gjejnë zbatim praktik në bankat komerciale. Duke marrë për bazë rekomandimet e dala nga ky punim, bankat mund të përmirësojnë proceset e vlerësimit të kredive dhe gjithashtu të përshpejtojnë procesin e harmonizimit të rregulloreve me standardet evropiane. Gjithashtu në bazë të këtyre rekomandimeve, bankat duhet të vazhdojnë lehtësirat

kreditore, në mënyrë që të rrisin kreditë e dhëna dhe gjithashtu të rrisin konkurrencën në sektorin bankar, duke ndikuar kështu në uljen e mëturjes së normës së interesit në kredi. Në përgjithësi rekomandohet që rezultatet e arritura nga hulumtimi të përdoren si bazë për ndryshime pozitive në sistemin bankar në Kosovë.

Hulumtime të mundshme të ardhshme

Punimi i disertacionit të doktoraturës më titull **“Ndikimi i menaxhimit efektiv të kredisë në përfitueshmërinë e Bankave komerciale në Kosovë”**, i kandidatës **Mr.sc. Donjeta Morina**, është punim që studion një problematikë aktuale shumë të rëndësishme të sektorit financiar. Arsyeshmëria e menaxhimit të rrezikut të kredisë është të minimizoj humbjet e mundshme që vijnë nga veprimtaria kreditore e bankës, si rezultat i moskthimit të kredive nga ana e klientëve ose si rezultat i ekzistencës së rrezikut kreditor. Aftësia e bankave për të realizuar fitim varet nga mënyra se si ato krijojnë kapësire të mjaftueshme për shmangien e rreziqeve, veçanësisht shmangien e rrezikut kreditor si rezultat i moskthimit të kredive të dhëna.

Më rastin e finalizimi të këtij disertacioni, mund të thuhet me bindje të plotë se kandidatja ka arritur t’i përmbahet objektivave të përcaktuara në fillim dhe ka arritur ta finalizoj më sukses qëllimin kryesor të këtij disertacioni. Me njohuri dhe përkushtim të madh ka arritur t’i plotësoj të gjitha kërkesat e parashtruara për realizimin e tij. Njohuritë shtesë të fituara gjatë kësaj periudhe dhe eksperiencia e fituar i mundësojnë realizimin e shumë studimeve në të ardhmën në këtë fushë të hulumtimit apo në fusha të ngjashme. Duke u bazuar në vlerën e hulumtimit të realizuar nga ana e vet kandidatës, mund të themi se kapacitetet e saja janë shumë premtuese për realizimin e shumë studimeve cilësore në të ardhmën. Nga ky studim mund të merren udhëzime të mirëfillta për iniciimin e hulumtimeve të ardhshme nga fusha e njëjtë e studimit. Prandaj, hulumtime të mundshme mund të realizohen mbi:

- Gjetjen e praktikave të reja mbi menaxhimin e rrezikut kreditor në bankat komerciale.
- Gjetjen e metodave me efektive mbi menaxhimin e rrezikut kreditor dhe përcaktimin e aftësisë paguese të klientëve.
- Përcaktimin e faktorëve të tjerë që ndikojnë në përfitueshmërinë e Bankave komerciale në Kosovë.
- Rolin e indikatorëve makroekonomik në përfitueshmërinë e Bankave komerciale, etj.


Përfundim me propozim deri të Këshilli – mësitor shkencor

Duke pasur parasysh lëndën e hulumtimit të disertacionit, qëllimin e hulumtimit, kontributin shkencor të hulumtimit, pritjet shkencore nga hulumtimi, fushën shkencore të hulumtimit, rezultatet e hulumtimit, kontributet kryesore shkencore të kandidatës, fushën shkencore në të cilën do të aplikohen rezultatet, hulumtimet e mundshme në të ardhmën, komisioni konstaton që punimi i disertacionit të doktoraturës së kandidatës **Mr.Sc. Donjeta Morina** me titull “**Ndikimi i menaxhimit efektiv të kredisë në përfitueshmërinë e Bankave komerciale në Kosovë**”, i plotëson të gjitha kriteriumet bazë të nenit 208 të Statutit të Universitetit të Tetovës, nenit 51 të Rregllorës për kushtet, kriteret dhe rregullat e regjistrimit dhe studimit në ciklin e tretë të studimeve – studimet e doktoraturës. Njëkohësisht punimi në fjalë i plotëson kriteret e arsimimit, qasjes aplikative shkencore, me të cilat njëherit i plotëson të gjitha kushtet e një punimi të pavarur hulumtues – shkencor.

Komisioni i propozon Këshillit mësitor – shkencor të Fakultetit Ekonomik, që të sjellë **VENDIM** për miratim të këtij raporti dhe të vazhdohet procedura për caktim të datës së mbrojtjes së tezës së doktoraturës “**Ndikimi i menaxhimit efektiv të kredisë në përfitueshmërinë e Bankave komerciale në Kosovë**” të kandidatës **Mr.Sc. Donjeta Morina**.

Komisioni:

1. Prof. dr. Ibish Mazreku – kryetar
2. Prof. dr. Shirete Elezi – anëtar
3. Prof. dr. Etem Iseni – anëtar
4. Prof. dr. Arun Tairi – anëtar
5. Prof. dr. Bardhyl Dauti – anëtar



The image shows five handwritten signatures in blue ink, each written on a horizontal line. The signatures are: 1. A large, stylized signature (likely the chairperson). 2. A signature that appears to be 'Shirete Elezi'. 3. A signature that appears to be 'Etem Iseni'. 4. A signature that appears to be 'Arun Tairi'. 5. A signature that appears to be 'Bardhyl Dauti'.

Tetor, 2021